

# Ditari Natyrës

Nr. 56 Viti i gjashtë i botimit Janar 2018

Në këtë numër do të gjeni:

- ...me këtë raët Ju kujtojmë se...
- Promovimi dhe adresimi i përdorimit të qëndrueshëm të burimeve dhe vlerave natyrore në ZM
- Menaxhimi Ndërkufitar i Ekosistemeve në Sharr/ŠarPlanina-Korab-Kortinik
- Takimi i Tretë i Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës
- Tryezë e Rrumbullakët "Procedurat e VNM/VSM - analiza, rekomandimet dhe shembujt më të mirë të zbatimit të tyre"
- Si e përmirëson pjesëmarrja publike vendimmarjen për çështjet mjedisore?
- Të njihemi më shumë me energjinë / nga Qendra EDEN
- Njoftime



Gëzuar 2018!



www.inca-al.org  
INCA Albania  
Instituti për Ruajtjen e Natyrës  
Tiranë, Albania  
Tel/Fax: +355 4221007

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri i uron Gëzuar Festat e fund vitit të gjithë lexuesve, miqve, kolegëve, bashkëpunëtorëve dhe dashamirësve duke i falenderuar për mbështetjen e vazhdueshme dhe bashkëpunimin e ftyrëshëm në fushën e ruajtjes së natyrës dhe mjedisit në vendin tonë.

Ne kemi bindjen që Viti i RI 2018 do të sjellë më shumë bashkëpunime, angazhime e përpjekje në realizimin e qëllimit tonë të përbashkët, ruajtjen e natyrës shqiptare dhe krijimin e një mjedisit sa më të qëndrueshëm për sot dhe brezat që do të vijnë.

## ... me këtë rast Ju kujtojmë se 22 vjet më parë ...

...me VKM Nr. 102, datë 15.01.1996 "Për miratimin në parim të strategjisë për zbatimin e projektit për vlerësimin mjedisor nga zbatimi i projektit të pyjeve (aneksi Rrjeti i Zonave të Mbrojtura)", pas studimit ekologjik të pyjeve të virgjërtë Shqipërisë, u miratuan:

### 1. Rezervat Strikt Natyror

1. Lumi i Gashit, me sipërfaqe 3,000.0 ha, qarku Kukës, rrethi Tropojë.

2. Kardhiqi, me sipërfaqe 1,800.0 ha, qarku Gjirokastër, rrethi Gjirokastër.

3. Laguna e Karavastasë, me sipërfaqe 5,000.0 ha, qarku Fier, rrethi Lushnjë, më pas u përfshih në sipërfaqen e zgjeruar të PK "Divjakë-Karavasta".

4. Rajca, me sipërfaqe 4,700.0 ha, qarku Elbasan, rrethi Librazhd, më pas u përfshih në sipërfaqen e PK "Shebenik-Jabllanicë".

### 2. Park Kombëtar

1. Lugina e Yalbonës, me sipërfaqe 8,000.0 ha, qarku Kukës, rrethi Tropojë.

2. Mali i Tomorrit, me sipërfaqe 4,000.0 ha, qarku Berat, rrethi Berat, më pas u përfshih në sipërfaqen e PK "Mali i Tomorrit".

3. Bredhi i Hotovës, me sipërfaqe 1,200.0 ha, qarku Gjirokastër, rrethi Përmet, më pas u përfshih në sipërfaqen e PK "Bredhi i Hotovës-Dangëlli".

4. Qafë Shtama, me sipërfaqe 2,000.0 ha, qarku Durrës, rrethi Krujë.

### 5. Zall Gjocaj 140 ha

### 3. Monument Natyre

1. Bredhi i Gotirës, me sipërfaqe 1,740.0 ha, qarku Gjirokastër, rrethi Gjirokastër.

2. Zhej, me sipërfaqe 1,500.0 ha, qarku Gjirokastër, rrethi Gjirokastër.

3. Syri i Kaltër, me sipërfaqe 180.0 ha, qarku Vlorë, rrethi Delvinë.

4. Vlashaj, me sipërfaqe 50.0 ha, qarku Dibër, rrethi Peshkopi.

### 4. Rezervat Natyror i Menaxhuar

1. Rrëzoma, me sipërfaqe 1,490.0 ha, qarku Vlorë, rrethi Delvinë.

2. Tej Drini i Bardhë, me sipërfaqe 30.0 ha, qarku Kukës, rrethi Haç.

3. Gërmend-Shelegur, me sipërfaqe 430.0 ha, qarku Korçë, rrethi Kolonjë.

4. Polis, me sipërfaqe 45.0 ha, qarku

Elbasan, rrethi Librazhd.

5. Stravaj, me sipërfaqe 400.0 ha, qarku Elbasan, rrethi Librazhd.

6. Sopot, me sipërfaqe 300.0 ha, qarku Elbasan, rrethi Librazhd.

7. Dardhë-Xhyrë, me sipërfaqe 400.0 ha, qarku Elbasan, rrethi Librazhd.

8. Qarrishtë, me sipërfaqe 318 ha, qarku Elbasan, rrethi Librazhd.

### 5. Peizazhi Mbrojtur

1. Nikolicë, me sipërfaqe 510.0 ha, qarku Korçë, rrethi Devoll.

2. Bizë, me sipërfaqe 1370 ha, qarku Tiranë, rrethi Tiranë, më pas përfshihet në PM "Mali me Gropa-Bizë-Martanesh".

3. Berdheti, me sipërfaqe 670 ha, qarku Tiranë, rrethi Tiranë, më pas përfshihet në PM "Mali me Gropa-Bizë-Martanesh".

### 6. Zonë e Mbrojtur e Burimeve Natyrore të Menaxhuara

1. Luzni-Bulaç, me sipërfaqe 5,900.0 ha, qarku Dibër, rrethi Peshkopi e Bulqizë.

2. Piskë-Shqeri, me sipërfaqe 5,400.0 ha, qarku Korçë, rrethi Kolonjë.

3. Bjeshka e Orosit, me sipërfaqe 4.745.0 ha, qarku Lezhë, rrethi Mirditë.

4. Guri i Nikës, me sipërfaqe 2,000.0 ha, qarku Korçë, rrethi Pogradec.

AKZM me strukturat e saj të vartësise, ka detyrë dhe duhet të jetë e kujdeseshme që të evidentojnë dhe të marrin masa për kremitimin me dinjitet të këtyre datave historike, duke hapur një faqe të re në punën e tyre, për njohjen dhe promovimin e zonave të mbrojtura, duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet dhe shoqërinë civile.

INCA është e gatshëme që të ndihmojë për promovimin e vlerave të natyrës e të biodiversitetit, në ngritjen e kapaciteteve për përmirësimin e menaxhimit të rrjetit të zonave të mbrojtura dhe në hartimin e historisë së zonave të mbrojtura të Shqipërisë.

## Promovimi dhe adresimi i përdorimit të qëndrueshëm të burimeve dhe vlerave natyrore në Zonat e Mbrojtura

Parku Kombëtar Divjake-Karavasta - 5 Dhjetor 2017 - Në kuadër të 5 Dhjetorit, Dites Botërore të Tokës (bujqesore), si dhe Dites Ndërkombëtare të Vullnetarizmit, INCA organizoi disa aktivitete me Gratë e Parkut Kombëtar "Divjake-Karavasta".



Me financim të INCA u mbollen rrëth 100 fidane pishe e butë si dhe u solidarizua me nismen "Të pastrojmë Shqipërinë që duam" duke pastruar ambientet e parkut. Në fund, në kuadër të promovimit të vlerave natyrore të Parkut, u organizua edhe vezhgimi i zogjeve të parkut si pelikani, flamingo, rosa të egra, karabullak etj si dhe bukuritë që ofron peisazhi i Parkut.

Ky aktivitet zhvillohet në kuadër të programit SENIOR II Albania, zbatuar nga REC Shqipëri, financuar nga Qeveria suedeze (Embassy of Sweden in Tirana)



## Menaxhimi Ndërkufitar i Ekosistemeve në Sharr/ŠarPlanina-Korab-Kortinik

Tiranë 12-13 Dhjetor 2017 - Në kuadër dhe me mbështetjen e projektit "Shërbimet e Ekosistemit Ndërkufitar" të GIZ, INCA organizoi Takimin Bashkëpunues "Menaxhimi Ndërkufitar i Ekosistemeve në Sharr/ŠarPlanina-Korab-Kortinik".



Qëllimi i takimit ishte të bashkojë grupet e interesit nga tre vendet me qëllim prezantimin dhe vlerësimin e situatës aktuale të bashkëpunimit ndërkufitar në zonën trepalëshe, identifikimin e problemeve ekzistuese si dhe për-

të ndarë idetë dhe praktikat më të mira për përmirësimin e situatës si dhe forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit mes vendeve në të ardhmen.

Gjithashtu takimi u fokusua në diskutime për krijimin e një mekanizmi ndërkufitar bashkëpunimi i cili do të hapë rrugën në të ardhmen për krijimin e një strukture të përbashkët menaxhimi për zonën trepalëshe siç është rënë dakort në Vizionin e Përbashkët për Zonën e Mbrojtur Ndërkufitare të Sharrit Korab-Kortinik nënshkruar në 2013 dhe konfirmuar nga Deklarata e përbashkët e tre ministrave të Mjedisit të tre vendeve (Shqipëri, Maqedoni dhe Kosovë) në Mars 2017.



## Takimi i Tretë i Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës

Tiranë - 14 Dhjetor 2017 - Në ambientet e INCA u zhvillua takimi i tretë koordinues i Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës. Qëllimi kryesor i këtij takimi ishte diskutimi i planit të punës, mbarëvajtja e aktivitetave përgjatë periudhës që lamë pas, si dhe diskutimi i aktivitetave të Rrjetit në të ardhmen.

Në takim u diskutuan çështje si ecuria e projektit dhe masat përmbylljen e tij, skema e raportit përfundimtar, skema e paraqitjes në hartë e impakteve negative të identifikuara për Zonat e Mbrojtura të marra në studim. Mbi këtë çështje u bë edhe një prazantim nga eksperti i GIS.



Adresimi i problematikave me cilat përballen Zonat e Mbrojtura si dhe promovimi i vlerave të këtyre zonave përmes zërit të shoqërisë civile dhe komunitetit lokal, është fokusi kryesor i këtij projekti. Ai ka si objektiv të përgjithshem të kontribojë në menaxhimin e qëndrueshëm të Zonave të Mbrojtura nëpërmjet forcimit të rolit aktiv dhe pjesëmarrës të Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile.

Ky takim zhvillohet në kuadër të projektit "Promovimi dhe adresimi i përdorimit të qëndrueshëm të burimeve dhe vlerave natyrore në zonat e mbrojtura", pjesë e programit SENIOR-II Albania (Senior Albania), zbatuar nga REC Shqipëri, financuar nga qeveria suedeze (Embassy of Sweden in Tirana).



## Tryezë e Rrumbullakët "Procedurat e VNM/VSM - analiza, rekomandimet dhe shembujt më të mirë të zbatimit të tyre"

Tiranë 22 Dhjetor 2017 - Në kuadër të projektit CO-SEED - "Shoqëria Civile vepron për Zhvillimin Social-Ekonomic mbi Bazat e një Mjedisë të Shëndetshëm", Instituti për Ruajtjen e Natyrës (INCA), organizoi tryezën e rrumbullakët me përfaqësuesit e AKM, ekspertëve të studimeve të VNM/VSM (Vlerësimi i ndikimit në Mjedis/Vlerësimi Strategjik i Ndikimit në Mjedis) dhe organizatave të shoqërisë civile, me temë "Procedurat e VNM/VSM - analiza, rekomandimet dhe shembujt më të mirë të zbatimit të tyre".



Në këtë tryezë mori pjesë dhe Drejtori i AKM, Edison Konomi, i cili theksoi se brenda 6 muajorit të parë vitit 2018 do të rishikohen të gjithë procedurat e dhënes së lejeve për studiot e licensuara në përgatitjen e VNM, Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis. "Ka një rregull: Kushton më pak ta parandalosh një sëmundje se sa ta kurosh atë dhe unë mendoj se një pjesë e mjedisit është e sëmurë. Atëherë të gjithë së bashku të punojmë që ta shpëtojmë pjesën e shëndetshme dhe ta rikuperojmë pjesën e sëmurë", tha Konomi.

Në këtë takim drejtori i AKM-së Edison Konomi, siguroi bashkëpunimin mes shoqërisë civile me institucionet përgjegjëse për një proces sa më transparent. Shprehja nga ana tij e gatishmërisë për bashkëpunim të vazdueshëm në lidhje me përmirësimin e procesit është një fillim i mbarë i komunikimit midis aktorëve të rendësishëm të këtij procesi.

"Qasja e AKM në miratimin e VNM-ve dhe procedurave të ndikimit në mjedis, është me rendësi dhe tashmë po punohet për rishikimin e

gjithë kuadrit ligjor. Nisur nga zhvillimet e fundit në vend, por dhe nga kërkesat e shoqatave të mjedeleit, këto ndërhyrje shihen të nevojshme. Në 6 muajorin e parë të vitit 2018 do të rishikohen procedurat e licensimit të studiove që përgatisin VNM", tha Konomi.

Ky diskutim me bashkëpunëtorët do të vazhdojë edhe në aktivitetet e mëtejshme të projektit dhe veçanërisht në ato advokuese dhe lobuese për të arritur një proces të rregullt të bërjes së këtyre studimeve duke u shoqruar dhe me transparencë dhe pjesëmarrje të publikut dhe aktorëve në mënyrë aktive.

Projekti ka për qëllim të nxisë dhe të mundësojë një mjedis ligjor dhe finansiar për shoqerinë civile dhe media pluraliste, si dhe fuqizimin e organizatave të shoqërisë civile dhe medias për të qenë aktor të pavarur efikas dhe të përgjegjshëm, dhe për të rritur kapacitetin e tyre për të pasur dialog me qeveritë që ndikojnë proceset e politikave dhe ato vendimmarrëse dhe për t'i bërë ato të përgjegjshme për performancën e tyre ndaj qytetarëve dhe shoqërisë në shkallë të gjërë.

Projekti ka përgatitur gjatë zbatimit të tij raportin e analizës së thelluar të kuadrit ligjor dhe institucional për zbatimin e procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis të projekteve që



ndikojnë në mjedis si dhe të procedurave të vlerësimit strategjik mjedisor të strategjive, programeve dhe planeve të veprimit kombëtare duke evidentuar mangësitë dhe dhënë rekomandimet përkatëse të përmirësimit të këtij kuadri ligjor. Gjithashtu projekti ka përzgjedhur dhe disa shembuj të zbatimit të procedurave të transparencës, Vilon në faqe 7

Vijon nga faqe 6 informimit të publikut si dhe VNM/VSM në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim me synimin e prezantimit të këtyre shembujve si praktika të mira që janë për t'u marrë në konsideratë gjatë procesit të advokimit apo lobimit të përmirësimit të kuadrit ligjor dhe zbatueshmërinë e tij.

Duke u nisur nga rëndësia e këtyre problemeve, INCA si partnere e këtij projekti, organizoi këtë tryezë të rrumbullakët për të diskutuar mbi gjetjet nga analiza e kuadrit ligjor dhe institucional të gjithë procesit të përgatitjes dhe diskutimit të studimeve të VNM dhe VSM në mënyrë që të bashkëpunohet për ta përmirësuar

këtë proces duke nxitur advokimin në nivelet e duhura e për ta finalizuar këtë proces dhe me lobim për ndryshimet ligjore që ndikojnë në bërjen e këtij procesi sa më transparent dhe gjithëpërfshirës.

Pjesëmarrësit dhanë gjatë këtij eventi



mendimet e tyre për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe atë institucional në rritje të pjesëmarrjes të sa më shumë aktorëve, si dhe të rritjes së transparancës dhe pjesëmarrjes në vendimmarrje. Projekti CO-SEED: po zbatohet në vendet: Shqipëri, Boenje dhe Hercegovinë, Mal i Zi, Serbi dhe Turqi. Partneri kryesor që drejton zbatimin e projektit (Koordinator) është EEF Turqi. Partnerët e projektit janë: INCA (Instituti për

Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri) Shqipëri, Udruga Dinarica, Boenja dhe Hercegovina, EEF Adria, Kroaci, Zeleni Dom - Green Home, Mal i Zi dhe Shoqata e Studimeve Shoqërore dhe Mbrojtjes së Shpendëve të Serbieë.

Projekti financohet nga Bashkimi Evropian përmes programit të lehtësimit të Shoqërisë Civile dhe mediave të Bashkimit Evropian 2014-2015 - Mbështetje për rrjetet rajonale tematike të Organizatave të Shoqërisë Civile.

## Si e përmirëson pjesëmarrja publike vendimmarrjen për çështjet mjedisore?



Fragmente nga manuali i praktikave më të mira botërore

Shteti: Namibi

Rasti: Plan i përdorimit të tokës Sperrgebiet

Theksi: Përfshirja në fazat e para e të gjitha palëve siguron arritjen e qëllimeve afatgjata.

Territori Sperrgebiet, që është pjesë e shkretëtirës së Namibisë, ka rëndësi botërore për biodiversitetin endemik. Njëkohësisht, aty janë bërë gjermime të shumta diamante që prej shekullit të XX. Aksesi në këto zona është i kufizuar për arsyet sigurie, gjë që ka mundësuar ruajtjen e natyrës së kësaj zone. Gjithashtu, tryeria e zgjerimit të industriës së minierave dhe sektorit të turizmit ka sjellë hartimin e një plani për përdorimin e tokës nga ministritë namibiane përtë menaxhuar zhvillimin aktual dhe të ardhshëm të Sperrgebiet-it. Zhvillimi i këtij plani përfshinte hapat e mëposhtme: (i) të

kuptuarit e vlerave të biodiversitetit nëpërmjet studimeve shtesë dhe hartëzimit të ndjeshmërisë (ii) identifikimin e mundësive për përdorimin e tokës dhe vlerësimin e tyre për sa i përket ndikimeve mjedisore (iii) formulimin e një vizioni afatgjatë që i gjithë territori i Sperrgebiet duhet të shpallet zonë e mbrojtur, dhe (iv) hartimin e një kuadri administrativ për të mbështetur procesin ligjor të planifikimit të përdorimit të tokës.

U zbatua një program konsultimesh gjithëpërfshirëse i cili përfshin: workshop-ët publike, fletëpalosje për informim dhe formularë reagimi, pyetësorë për përdorimin e tokës, si dhe një workshop teknik me ekspertë të zgjedhur.

Të gjitha proceset u finalizuan me adoptimin me sukses të një plani për përdorimin e tokës, dhe shpalljen e Sperrgebiet-it si Park Kombëtar.

## Të njihemi më shumë me energjinë

nga Qendra EDEN

Si mund ta sjellim më afër publikut të gjerë një temë kaq të rëndësishme dhe delikate për gjithë qytetarët? Organizatat e rrjetit të Vigjilencës Mjedisore e menduan këtë gjë në mënyrën më të kuptueshme e tërheqëse, duke zhvilluar një



aktivitet në një vend të hapur të secilit qytet zbatues të projekteve "Së bashku një sy për mjedisin". Me anë të këtij aktiviteti synohej të informohej publiku për situatën energjetike në vend dhe për eficencën energjetike, duke paraqitur dhe disa nga rezultatet e dala nga pyetësorët e Varfërisë Energjetike në familje. Secili qytet përmes një infografike kishte të paraqitur disa fakte kryesore të situatës energjetike në Shqipëri dhe të varfërisë energjetike në qytet. Pjesa kulminante dhe më entuziaste për qytetarët ishte mundësia që u dha për të provuar njohuritë e tyre në sektorin e energjisë duke luajtur me lojën "Rota e energjisë". Kjo lojë tërheqëse shërbente edhe si një mundësi e mirë për ti dhënë një informacion plotësues - ndërgjegjësues ku secili numër i ndarjeve të rrotës mbarte një pyetje specifike mbi energjinë. Llampat LED të eficencës A++ nuk mund të mungonin në aktivitet për të falenderuar e "shpërbyler" pjesëmarrësit të cilët merrnin pjesë në lojë duke gjetur pyetjet e energjisë.

Pjesëmarrja në secilin qytet ishte e ndjeshme dhe e dukehme, duke theksuar në këtë mënyrë interesin që kanë qytetarët për çështjen dhe rëndësinë e informimit të gjërë me përqasje sa më të kuptueshme dhe që ndjellin kuriozitet. Nxënësit e shkollave dhe qytetarë të moshave

të ndryshme ishin përqindja më e madhe e të pranishmëve duke mos neglizhuar dhe interesin e shfaqur nga pushteti vendor, si në rastin e qytetit të Beratit me prezencën e nënkyetares së Bashkisë.

Të pranishmit në çdo qytet ndanë me organizuesit mendimet dhe ndjesitë e tyre në lidhje me aktivitetin, punën e kryer nga secila organizatë dhe rendësinë thelbësorë që ka fusha e energjisë në jetën e çdo familjeje.

Si më poshtë gjeni disa opinione të ndara nga qytetarët për të kuptuar perceptimet e tyre dhe faktin që jo vetëm lloji dhe tema e aktivitetit tërroqi vëmendjen e qytetarëvë, por edhe forma e zgjedhur përtat përquar atë:

-"Interesat tona duken të përfaqësuarë dhe jemi shumë të kënaqur me aktivitetin"

-"Loja e rrotës me ngjyrat dhe përmasat e saj është shumë interesante, e dalluam që nga larg dhe na intrigoi të afroheshim"

-"Sa më mirë që sollët një temë tjetër në vëmendjen e qytetarëve që lidhet me jetën tone, larg fokusit të politikës dhe medias"

-"Idë shumë e bukur dhe e re në llojin e vet"

-"Gjë e vegantë, nuk kishim këtë informacion për energjinë"

Aktiviteti i përbashkët i rrjetit të vigjilencës i ideuar dhe organizuar në sinkron u zhvillua në:

Shkodër: Qendra e Informacionit Aarhus, Te pedonalja afër me EU Info Center

Vlorë: Qendra për Kërkim,

Bashkëpunim dhe Zhvillim, Te

s k e l i a

Elbasan: Klubi Ekologjik

Elbasan, Përballë Kalasë

Berat: Për mirëqenie Sociale

dhe Mjedisore, përballë Hotel

T u r i z m i t

Tiranë: Qendra mjedisore për

Zhvillim Edukim dhe

Rrjetëzim dhe Qendra për

Mbrojtjen e Ekosistemeve

Natyrore në Shqipëri, Parku

Rinia Tajvani

Falenderojmë të gjithë

qytetarët për interesin e tyre dhe besojmë që ky aktivitet të ketë sjellë një informacion plus në

s h t ë p i t ë e g j i t h s e c i l i t !


Për më shumë ndiqni fotografitë në faqen facebook të rrjetit: [goo.gl/k49Bpm](http://goo.gl/k49Bpm)

Aktiviteti "Të njihemi më shumë me energjinë" nga rrjeti i vigjilencës mjedisore zbatues të projekteve "Së bashku një sy për mjedisin" mundësohet financiarisht nga Ambaeada Suedeze në Tiranë nëpërmjet programit Senior Albania zbatuar nga REC Shqipëri





**INSTITUTI PËR RUAJTJEN  
E NATYRËS NË SHQIPËRI**  
[www.inca-al.org](http://www.inca-al.org)



**Adr.:Rruga "Islam Alla"**  
Pallati IVEA, Kati I  
1001 Tirana-Albania

**Tel.:** +355 (0) 422 31 437  
**Fax:** +355 (0) 422 31 437  
**E-mail:** [info@inca-al.org](mailto:info@inca-al.org)

**INCA ALBANIA**   

## NJOFTIME

26 Janar - Dita Botërore e Edukimit Mjedisor  
27 Janar - Dita e Shërbimit Pyjor Shqiptar

1 - Përtë lexuar "Ditari i Natyrës" në vite...  
<http://www.inca-al.org/index.php/sq/publikimet/ditari-i-natyres>

### Udhëzime përtë kontribuar në Ditarin e Natyrës

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri mirëprejt artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi t'i publikoni në Ditarin e tij elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 200 - 250 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesni përtë shpërndarë artikuj, lajmë apo njoftime të ndryshme përmes Ditarit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi përtë siguruar hapësirë përtë qithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia ruan të drejtën përtë shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme.

Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese përtë artikullin tuaj dhe / ose web - link përtë referencë të mëtejshme. Faleminderit përtë marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

### Grupimi "Të Shpëtojmë Arinjtë Shqiptarë"



### Organizatat Partnere të Rrjetit përtë Mbrojtjen e Natyrës



Botim i Institutit përtë Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri / INCA  
Redakta: Nihat Dragoti; Ilirjan Qirjazi; Vilma Kadu; Marinela Mitro

**Adr.:Rruga "Islam Alla"**  
Pallati IVEA, Kati I  
1001 Tirana-Albania

**Tel.:** +355 (0) 422 31 437  
**Fax:** +355 (0) 422 31 437  
**E-mail:** [info@inca-al.org](mailto:info@inca-al.org)

[www.inca-al.org](http://www.inca-al.org)  
[info@inca-al.org](mailto:info@inca-al.org)  
[www.facebook.com/inca.albania](http://www.facebook.com/inca.albania)

**INCA ALBANIA**   